



KUVENDI I KOMUNËS

KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 10 korrik 2020, në mbledhjen e XXIV-të (njëzet e katër) të Komitetit për Komunitete, mandati VI.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, dhe filloi në orën 10;15.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Albina Avdiu Kryesuese e Komitetit,

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Valbona Kadriu-Podvorica, Benjamin Ejupi, Bashkim Syla, Doruntina Hasani, Valmire Lahu ndërsa munguan Mefail Rama dhe Radisav Perović.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin, Zaim Thaqi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Adem Ajvazi, zyrtar nga Drejtoria e Arsimit në Komunën e Podujevës, Gergina Kovacs dhe Laslo Siklosi, përfaqësues nga KFOR.

Rendi i ditës

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, e hapi mbledhjen ndër të tjera theksoi, konstatoj që janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, besoj që materialin e keni marrë me kohë dhe jeni në njohuri për pikat e rendit të ditës. Nëse ndokush ka diçka për të shtuar urdhëroni nëse jo atëherë e hedhë në votim këtë pikë të rendit të ditës.

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës.

1. Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Komunitete mbajtur më 09 qershor 2020.

Njëzëri u miratua Ekstrakti i procesverbalit

2. Informatë lidhur me gjendjen e krijuar nga Pandemi Covid-19 në Komunën e Podujevës.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, theksoi, siç po dihet, dita ditës numri i të prekurve me covid-19 vetëm po rritet, deri tani rreth 4100 është numri i të infektuarve në Kosovë, e nëse nuk gaboje 58 është në Komunën e Podujevës, një gjendje mjaft alarmante por që të mos humbim kohë unë ja kaloj fjalën drejtorit Zaim Thaqi.

z.Zaim Thaqi, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, theksoi, për situatën epidemiologjike kemi informacione të mjaftueshme pothuajse secili qytetar duke ju falënderuar mediave, rrjeteve sociale dhe interesimit që kemi të drejtpërdrejtë, mirëpo unë dua ti ndaj disa detaje. DSHMS kryesisht veprimtarin e saj e ka të drejtuar në dy komponentë e që është, komponenta e shëndetësisë dhe komponenta e mirëqenies sociale. Me komponenten shëndetësore jemi duke u munduar që qytetarëve të ju ofrojmë shërbime, në pikën kufitare në Mendarë me ekipin shëndetësorë 24 orë, pastaj me ekipet në njësinë e triazhimit që është në kuadër të QKMF-së dhe ajo është duke funksionuar 24 orë dhe komplet shërbimi i shëndetit publik 24 orë në shërbim të qytetarëve. Risi është që kohët e fundit e kemi marrë një mbështetje-leje nga Ministria e Shëndetësisë dhe tash marrja e mostrave për testime mund të bëhet në ambientet e shtëpisë së shëndetit nga profesionistët tanë shëndetësorë, ndërsa dërgimi i tyre dhe përpunimi do të bëhet nga laborator i mikrobiologjisë në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës. Është e vërtet që ditëve të fundit numri i rasteve pozitive është në rritje, edhe numri i testeve është në rritje, por janë edhe detaje tjera që edhe përkundër që është një sëmundje virale tek popullata e re vdekshmëria është shumë e ulët në Kosovë por edhe në komunën tonë. Mund të themi që nataliteti është i rritur ndërsa mortaliteti është i zvogëluar ose është në kuotat më minimale të mundshme duke e përfshirë regjionin.

Me komponentën sociale DSHMS në fakt Komuna e Podujevës është duke u munduar që qytetarëve, apo vlen ai elementi që familjet që kanë të prekur një anëtar apo pacient që rezulton pozitiv me covid-19 e kanë për obligim që të vetë izolojnë dhe ky izolim për familjen po krijon situatë të re në kuptimin e furnizimit me artikuj ushqimor elementar për hir të asaj që bëhet kufizimi i lirë i lëvizjes dhe për këtë Komuna e Podujevës dhe DSHMS kemi menduar që dhe e kemi krijuar një fond nga buxheti i Komunës, si dhe nga donatorët për pako ushqimore dhe higjienike që t'ju ofrohet atyre familjeve për periudhën për sa kohë të jenë të izoluar. Ditëve të fundit i kemi shpërndarë pako vetëm nga komuna për rreth 20 familje, kjo për shkak se nuk kanë kërkuar të gjitha familjet një ndihmë të tillë. Falë edhe donatorëve që kohë pas kohe shfaqen dhe na ndihmojnë neve që të ju përgjigjemi familjeve në nevojë.

Mund të themi që situatën epidemiologjike në Komunën e Podujevës e kemi nën kontroll falë angazhimit të Institucioneve, të të gjithë akterëve, profesionistëve shëndetësor dhe profesionistëve të fushave tjera, falë organeve të sigurisë dhe organizatave tjera të cilat kontribuojnë në këtë çështje. Pra kjo ishte për fillim por nëse ndokush ka ndonjë pyetje direkte që mendoni që mund t'ju jap përgjigje, urdhëroni.

znj.Doruntina Hasani, pyeti, drejtori para folës e tha që situata është nën kontroll në Komunën e Podujevës, e kam përcjellë numrin e testeve nuk është që është rritë deri tash ditëve të fundit por sa është numri i testeve që janë bërë në Komunën e Podujevës sepse unë kam informacione që ky numër është shumë i vogël dhe po testohen vetëm me simptoma.

Kam biseduar edhe me disa që janë të prekur me covid-19, saktësisht një familje në Gërdoc më ka shkruar dhe familjarët e tyre kanë kërkuar të testohen por nuk janë testuar.

z.Zaim Thaqi, drejtor i DSHMS, përgjigje para folëses, theksoi, rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe të përcjella prej Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës të fundit janë që për të gjithë qytetarët që janë raste të kontaktit apo kontakte të kontakteve ka rënë ajo teoria sa i përket testimit të tyre për covid-19. Do të thotë rekomandimet e fundit janë që qytetarët që kanë absolutisht shenja të sëmundjes të bëhet testimi i tyre, jo të ndiqet siç ka qenë më parë në proceduar epidemiologjike prej rastit në rast dhe duke shkruar në progresion gjeometrik me qëllim që të hulumtohen kontaktet e kontaktit, kjo teori ka kaluar në një fazë tjetër dhe sipas rekomandimeve të OBSH-së të përcjella nga IKSHPK-ja thuhet që numri i testeve nuk duhet të

jetë i lartë, testimet të bëhen vetëm tek qytetarët të cilët kanë absolutisht shenja apo simptoma. Ne për hir të asaj që të jemi afër qytetarëve dhe kërkesave të tyre, tendenca jonë ditëve të fundit që të kërkojmë të bëjmë më shumë teste për qytetarët por janë rekomandimet e OBSH-së dhe IKSHP-së të cilat nuk guxojmë t'i anashkalojmë apo të nxjerrim konkluzë të reja përveç atyre që janë.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, ne e dimë që Podujeva ka një territor shumë të gjerë dhe pothuajse fshatrat dhe qytetin i ka përfshi covid-19 dhe e dimë që po të shkojmë me raste të kontaktit ka shumë raste dhe për këtë arsye deshta me ditë sa është numri i rasteve që testohen në laborator.

z.Zaim Thaqi, drejtor i DSHMS, përgjigje parafolësës, deri tani, nga muaji mars në Komunën e Podujevës janë testuar rreth 400 qytetarë. Madje tani edhe nuk mund me hy askush në një institucion shëndetësorë, ta zëmë për intervenim kirurgjik e të ngjashme, pa iu bërë testi dhe shpesh herë ata pacient mund ta kenë letërnjoftimin e Prishtinës ose të Podujevës dhe informacionet që na vinë neve shpesh nga Qendra për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve Ngjitëse vijnë vetëm për qytetarët që kanë adresën e letërnjoftimit në Podujevë, madje ndodh shpesh herë të ketë edhe lëshime në informacione. Ajo çfarë dua të them është që kemi rreth 400 testime dhe prej tyre 55 raste janë të konfirmuara pozitiv me covid-19, më duket 32 raste janë të shëruar dhe pjesa tjetër janë aktive. Për dallim nga fillimi i pandemisë tani qëndrimet për trajtimin dhe përcjelljen e rasteve epidemiologjike kanë ndryshuar dhe tani jemi në një stad tjetër. Në fillim janë ndjekë kontaktet e kontakteve, sot nuk praktikohet ajo formë, tani vetëm nëse kanë shenja të sëmundjes. Nga këto raste të konfirmuara pozitiv ne kemi kontakte të përditshme me ata qytetarë dhe jemi duke u munduar t'i mbështesim edhe me shërbime shëndetësore edhe me ato sociale, gjendja e tyre shëndetësore është shumë e mirë, asnjë prej këtyre pacientëve që janë të testuar pozitiv me covid-19 nuk e kanë gjendjen e rënduar shëndetësore, trajtimi i tyre dhe vetë izolimin e kanë në shtëpi pa kurrfarë shërbimi shëndetësor, ata kanë rezultat pozitiv por gjendja e tyre shëndetësore është e mirë. Ky është një argument që mundemi të themi se situatën epidemiologjike në Komunën e Podujevës e kemi nën kontrollë, e kemi në kontroll sepse atyre ju ofrohet shërbim shëndetësorë, ju ofrohet shërbim për dezinfektimin e hapësirave të banimit personal dhe privat ku ata jetojnë dhe aty ku mundemi dhe kërkohet ju ofrojmë edhe shërbime sociale si pako ushqimore, higjienike e kështu me radhë.

z.Bashkim Sylja, theksoi, ne e dimë që shumica prej të infektuarve kanë simptoma shumë të pakta, a ka mundësi të trajtohen ata në Podujevë që mos të shkojnë në infektivë ku pastaj ndonjë përcjellës i tyre pastaj mund të infektohet me covid-19, dhe a ka kapacitete Komuna jonë që në bazë të protokolleve për shërimin e të prekurve dhe ekzaminimi ta kryej në Podujevë, si dhe në rast se rëndohet kjo gjendje a ka kapacitete Komuna jonë të trajtoj ndonjë pacient të shtrirë me simptoma më të rënda, a ka përgatitje për këtë çështje.

z.Zaim Thaqi, drejtor i DSHMS, përgjigje parafolësit, sa i përket testimeve unë e ceka se mostrat e para merren në Shtëpinë e Shëndetit në Podujevë nga punëtorët shëndetësor të QKMF-së dhe ato mostra dërgohen në të njëjtën ditë në laborator të mikrobiologjisë në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës në Prishtinë, dhe kjo praktikë do të vazhdojë, ndërsa përpunimi i mostrave dhe rezultatet do të nxirren sërish nga IKSHPK.

Sa i përket pyetjes rreth përgatitjeve dhe kapaciteteve në rast se situata zhvillohet ndryshe, është çështje dhe obligim i Ministrisë së Shëndetësisë dhe i IKSHPK-së, ne vetëm i zbatojmë rekomandimet e tyre, por në momentin që kërkohet diçka e tillë nga ne, absolutisht që po. Informacionet që i kemi janë që Ministria e Shëndetësisë i ka vë në dispozicion spitalet regjionale për trajtimin e pacientëve të cilët është e mundur të trajtohen, por jo ndoshta ata pacient të cilët janë në situatë të rënduar siç është ventilimi mekanik, në momentin që kërkohet diçka nga ne t'ju

ofrojmë hapësirë ne jemi absolutisht të gatshëm, këtu e kemi edhe Spitalin e Përgjithshëm i cili është Institucion që duhet të menaxhohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe në momentin kur e shohin ata të arsyeshme, unë mendoj që ka kapacitete t'i trajtoj me dhjetëra raste në Podujevë, por deri më tani nuk është kërkuar një gjë e tillë.

z.Bashkim Sylja, theksoi, testet bëhen këtu dhe rezultati del pas 2-3 dite, rastet e lehta a mundemi t'i trajtojmë këtu, a kemi infektolog këtu apo duhet shkuar gjithsesi në Klinik në Prishtinë me familjarë për t'u bërë përshkrimi i barnave/terapisë dhe pastaj të kthehen pacientët në shtëpitë e tyre e që është rrezik pastaj të infektohen edhe të tjerët / përcjellësit.

z.Zaim Thaqi, drejtor i DSHMS, përgjigje parafolësit, ne si Komunë kemi institucionet që menaxhohen nga Komuna e që është niveli parësor shëndetësor dhe ky nivel i përfshinë mjekët familjarë, do të thotë, sipas Ligjit për shëndetësi ne i takojmë nivelit parësor shëndetësorë, dhe profesionistët shëndetësor janë mjekët familjarë, nuk ka infektolog, nuk ka ortoped, nuk ka kirurg ndërsa, dhënia e terapisë ne e dimë protokollin e trajtimit të sëmundjes me covid-19, është një protokoll me tri-katër barna por niveli parësorë shëndetësor për momentin nuk ka kompetencë për t'i shkruar dhe përcjellur, unë mendoj që është çështje klinike dhe në këtë rast covid-19 është çështje shumë e ndjeshme, është çështje shumë serioze të cilën nuk ka kaluar trajtimi në nivel të Shtëpisë së Shëndetit, por është në nivel spitalor.

z.Benjamin Ejupi, theksoi, e falënderoj drejtorin për informatat dhe që ka gjetur kohë të raportoj, sigurisht që është e rëndësishme të trajtojmë situatën e përgjithshme në tërë Komunën e Podujevës por meqenëse jemi në Komitet për Komunitete deshta të dijë a është bërë ndonjë testim tek komuniteti jo shumicë, edhe pse e dimë fatmirësisht nuk kemi asnjë rast të prekur me covid-19 nga ky komunitet, a është e gatshme Komuna që në rast të ndonjë kërkesa nga këto familje të komiteteve jo shumicë t'ju ndihmoj me pako ushqimore dhe higjienike dhe t'ju dal në ndihmë në përgjithësi.

z.Zaim Thaqi, drejtor i DSHMS, përgjigje parafolësit, theksoi, testimi i qytetarëve bëhet vetëm atëherë kur ata kanë simptoma të sëmundjes, është duke u planifikuar testimi i imunitetit kolektiv dhe nëse bëhet ky lloj i testimit, e që unë e kam potencuar që duhet të bëhet testimi i imunitetit kolektiv, në këtë testim mund t'i përfshijmë, shembull, lagjen apo familjet që jetojnë te hekurudha, por ne nuk kemi kaluar ende në atë fazë, ne jemi në fazën kur kemi të sëmur aktiv dhe ende nuk kemi mundur të arrijmë deri tek epilogu i kësaj pandemie. Deri më tani testimi i qytetarëve bëhet vetëm kur kanë shenja të sëmundjes.

Sa i përket mbështetje me pako ushqimore dhe higjienike ne absolutisht brenda mundësive asnjëherë nuk e kemi anashkaluar komunitetet jo shumicë. Kemi dëshmi të mjaftueshme në DSHMS që jemi mundua dhe i kemi përfshirë si një strukturë e cila duhet të mbështetet aq sa kemi pasur mundësi dhe jemi të gatshëm t'ju ndihmojmë aq sa kemi mundësi.

znj.Albina Avdiu, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e konstatoj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

3. Informatë rreth mbarimit të vitit shkollor 2019/2020, sfidat e nxënësve të komunitetit jo shumicë.

z.Adem Ajvazi, zyrtar nga Drejtoria Komunale e Arsimit, theksoi, pandemia covid-19 na detyroi të bëjmë rregulla të reja për mënyrën e jetesës, kur flas për zhvillimin e procesit arsimor në distancë ose mësimin online në fillim është transmetuar në Radio Televizionin e Kosovës – RTK për nxënësit deri në klasën e V-të i cili është bërë në formën e shkurtuar deri në 15 minuta dhe

mendoj që ka jap një sukses modest, mirëpo dalëngadalë ka filluar të perfeksionohet mënyra e punës nga mësimdhënësit tanë të cilët fatmirësisht janë në shumicë gjeneratë e re dhe e njohin më mirë teknologjinë. Sistemi zoom ka dhënë një rezultat të mirë po flas për klasat I-rë deri V-së, në ciklin e ulët, ndërsa më vonë kanë filluar edhe cikli i klasave VI-të deri IX-të si dhe shkollat e mesme. Trekëndëshi që ka funksionuar në Komunën tonë, Ministri- DKA-shkollë i ka pasur përparësitë po edhe mangësitë e veta. Në fillim kemi pasur vështirësi sepse tek një numër i familjeve, konkretisht në viset e thella malore, kemi pasur mungesë të teknologjisë për shkak të aspektit social ku ka mungua edhe rrjeti i internetit dhe ka qenë qasja më e vështirë të përcillet nga mësimdhënësit, mirëpo dalëngadalë është tejkaluar edhe ky problem në masë të madhe.

Drejtorja e Arsimit ka bërë ndarjen e zyrarëve në katër grupe për t'i përcjellë shkollat fillore dhe të mesme, prandaj mësimi që është zhvilluar, pengesat më të mëdha kanë qenë tek familjet fatkeqësisht, fjala është për te familjet ku ka munguar një vetëdijesim më i madhe dhe kanë qenë më të pa informuar, ndërsa te fëmijët me prindër më aktivë në shkollim kanë qenë në funksion më të mirë me fëmijët, mirëpo në fillim kemi pasur më së shumti vështirësi tek komunitetet RAE, drejtori i DKA-së ka pasur kontakte edhe me përfaqësuesit e tyre sepse në fillim kanë pasur hezitim të kyçen, konkretisht të jenë aktiv në sistem, fjala është te fëmijët në ciklin fillorë, mirëpo ne ju kemi bërë presion dhe kanë filluar të kyçen dhe rreth 90% e tyre kanë qenë aktiv, po flas për komunitetin RAE. Vështëritë kanë qenë paksa për shkak të teknologjisë mirëpo ajo forma e shpjegimit që e ka bërë Ministria e Arsimit përmes RTK-së ka qenë më e lehtë dhe është përcjellë ajo pjesë që është dhënë nga RTK.

Konsideroj që këtë vit, për këtë kohë që na ka rënë të punojmë në distancë është bërë një përvojë modeste, dhashtë Zoti që mos të vazhdoj me këtë trend dhe mënyrë të punës edhe në vijim procesi arsimor, mirëpo nëse na bie të punojmë sërish kështu konsideroj që e kemi bërë një përvojë dhe puna do të shkoj më mirë. Në bazë të të dhënave që na kanë ardhur nga shkollat fillore po ashtu edhe të mesme në përgjithësi kemi një rezultat solid të kënaqshëm, kuptohet për vlerësim janë zgjedhur forma të ndryshme të vlerësimit, mirëpo është sugjeruar të merret për bazë periudha e parë kur nxënësi ka qenë fizikisht prezent në shkollë dhe është bazuar në këtë. Marrë në tersi ky vit shkollorë duke u bazuar në rrethanat që kemi punuar rezulton si vit i suksesshëm, kuptohet me defektet që na kanë përcjellë jo vetëm Komunën tonë por gjithë Kosovën dhe më gjerë.

znj. Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, theksoi, sa i përket sfidave të Komunitetit jo shumicë e dimë se procesi mësimor online ka qenë mjaft sfidues, dhe jo vetëm për nxënësit e komuniteteve jo shumicë por në përgjithësi për të gjitha Komunitetet e vendit, por sfidat më të mëdha normal që kanë ndikuar më shumë të nxënësit e Komuniteteve jo shumicë për shkak të mungesës së pajisjeve teknologjike.

Meqë jemi tek kjo pikë, tani vetëm sa ka përfunduar viti shkollor 2019/2020, kam pyetje, a keni ndonjë statistikë se sa nxënës të Komunitetit jo shumicë kanë përfunduar vitin shkollor, sa për shkak të mos mësimnxënies kanë rezultuar me humbjen e vitit, a keni ndonjë statistikë më të detajuar që do të mund të na njoftoni më hollësisht.

z. Adem Ajvazi, zyrtar nga Drejtoria Komunale e Arsimit, theksoi, të gjitha në detaje janë në DKA dhe në mënyrë gjenerale të përgjithësuar konstatoj se të gjithë nxënësit e Komunitetit jo shumicë të cilët kanë qenë të regjistruar para covid-19 dhe kanë qenë në sistem, nuk kemi ndonjë rast që është lajmëruar që nuk e ka përcjell mësimin apo që e ka ndërprerë atë, mirëpo për mos vijueshmërinë e mësimin, edhe para pandemisë kemi pasur raste të tilla ku pastaj si komunë kemi intervenuar me theks tek ata që janë kthyer nga jashtë vendit e që kemi pasur vështirësi sepse shpesh herë e kanë ndërpre mësimin, mirëpo të dhënat që i kemi ne janë se të gjithë ata që kanë qenë para pandemisë në mësimin normal, nuk kemi raste që e kanë ndërprerë.

Të dhënat që na janë sjell nga drejtorët e shkollave sepse sa për informim ne kemi kërkuar gjithherë raporte javore, pastaj ne kemi bërë raportet mujore dhe e kemi pasqyruar se si po ecën mësimi dhe që është dashtë patjetër edhe Ministrisë së Arsimit t'ja pasqyrojmë punët se si po zhvillohen, kështu që në detaje nuk i kamë raportet mirëpo ato janë në DKA por nëse dëshironi mund t'jua sjellë, mirëpo në përgjithësi i pasqyrova dhe nuk kemi të dhëna që ka ndërprerje apo braktisje të mësimit nga ndonjë nxënës i Komunitetit jo shumicë.

Vështirësitë ekzistojnë, kemi pasë raste kur kompania Elkos i ka ndarë 25 lloptop të vogël, ju kemi sugjeruar drejtorëve të shkollave që ata t'jua japin nxënësve që kanë nevojë më tepër, në shkolla të mesme është fjala, dhe ata i kanë shpërndarë e që ka raste që janë dhënë edhe për nxënës të Komunitetit jo shumicë. Nëse e shihni të arsyeshme, në takimin e radhës mund t'ju informojmë me numra dhe statistika dhe të pasqyrojmë gjendjen siç reale.

Marrë në tërësi nga konsultat që i kemi pasur dhe mbledhjet që i kemi mbajt me drejtorin r DKA-së, viti mësimor kalendarik 2019/2020, duke i parë rrethanat që kemi qenë me pandemi është vit i suksesshëm, kuptohet i suksesshëm themi gjithherë duke i llogaritur në çfarë rrethanash kemi punuar dhe çfarë kemi arritur, idealja nuk është bërë mirëpo konsideroj se konsistenca ka vazhduar dhe mësimi është zhvilluar pa problem, me përjashtim të ndonjë rasti.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, qe dy mbledhje radhazi kam cek se informata do të duhet të jetë në formë të shkruar dhe të njëjtat të dërgohet, si dhe në detaje, jo përgjithësisht dhe me ardhë këtu me raportu. Në fakt po më vjen keq që po të drejtohem ty (parafolësit *Adem Ajvazit*) por ish dashtë që të jenë në mënyrë të detajuar dhe të shkruar këto informata.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, theksoi, dua të ceku se kësaj radhe kemi kërkuar vetëm informatë lidhur me zhvillimin mësimor 2019/2020, po besoj që herën tjetër kanë me qenë më të saktë dhe do të na marrin parasysh kërkesat tona si Komitet, dhe do të jeni më detaj dhe me informata më të sakta.

z.Adem Ajvazi, zyrtar nga Drejtoria Komunale e Arsimit, theksoi, ju keni kërkuar informatë dhe në bazë të pikës së rendit të ditës i bie që informata të jetë e përgjithësuar, dhe atë e bëra unë, mirëpo nëse ka nevojë, herën tjetër vij me informatë të detajuar, ose mundem edhe në mënyrë elektronike t'jua dërgoj.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, ne mbledhjen e kemi afërsisht 1 herë në muaj, ne mbajmë edhe seancë të Kuvendit Komunal dhe po ta dija se sa nxënës të Komunitetit jo shumicë kanë mungesë si pasoj e pajisjeve të teknologjisë, ne do e kishim bërë një kërkesë në Kuvend, nëse e bëjmë kërkesën pas një muaji mund të jetë shumë vonë. Nëse kanë mbete prapa me mësimë kishin mund këtë periudhë të kërkojmë pajisje të IT-së dhe të gjitha ato materiale gjenden në ueb faqe në RTK e që do të mund t'i ndjeknin edhe pse me vonesë dhe të përmirësojnë notat, sepse sa jam në dijeni Ministria e Arsimit ka deklaruar që edhe në shtator munden të përmirësohen notat dhe suksesi.

z.Adem Ajvazi, zyrtar nga Drejtoria Komunale e Arsimit, theksoi, ajo çfarë e ceku parafolësja, nuk qëndron, ajo ka qenë mendjehetësi e Ministrisë në prononcimet e tij.

znj.Doruntina Hasani, shtoj, ajo çfarë e ceku parafolësi rreth materialeve në TV, mendoj se kjo mënyrë ka qenë e vështirë të përcillet sepse çdo kush që është munduar t'ia përcjell një fëmije atë mësim për 20-15 minuta nuk ka mundur ta bëjë një gjë të tillë pa e përcjellë ngadalë, duke e ndalë me pauza dhe t'ia sqaroj fëmijut të tij, kështu që nëse e kishim ditë ne numrin e saktë të atyre që nuk kanë pasë qasje për shkak të pajisjeve të IT-së, ne do kishim bërë ndonjë kërkesë në Kuvendin Komunal, mirëpo tani kjo çështje po zgjatet nëse mbetet për muajin e ardhshëm të sjellën të dhënat e që fëmijët po e pësojnë.

z.Adem Ajvazi, zyrtar nga Drejtoria Komunale e Arsimit, theksoi, unë është hera e parë që po marr pjesë si përfaqësues i DKA-së këtu dhe sipas rendit të ditës ju referova vetëm informatës së përgjithësuar e që mendoj se e pasqyrova shumë mirë, mirëpo për detaje keni të drejtë, nëse është kërkesë e juaja patjetër se do të ishte më mirë ta sjellim, por herëve tjera na drejtoheni qartë dhe disa ditë më herët se kërkonit informata të detajuara dhe ne mund t'i sjellim në formë të shkruar.

Sa i përket asaj që u cek rreth prononcimit të Ministrisë të MASHT-it, unë e konsideroj se ajo ka qenë një mendjelehtësi dhe aq më tepër kur ai është edhe profesor universiteti, e them këtë sepse nuk ka logjikë në asnjë vend në botë siç ka deklaruar ish Ministri i Arsimit se një vit shkollor përfundon, sikur në këtë rast viti 2019/2020, viti përfundon me 31 gusht dhe të thotë Ministri ka mundësi të bëhen ndryshime në nota, në momentin kur themi përfundon viti shkollor, përfundon çdo gjë, për këtë kanë reaguar edhe DKA-të nga të gjitha Komunat sepse ne si Drejtori pastaj mbetemi në pozitë jo të mirë, kështu që konsideroj se viti ka përfunduar, kërkesa juaj për informata të detajuara me shkrim është e drejtë dhe do të ja paraqes edhe drejtorit të Drejtorisë së Arsimit.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, theksoi, pasi që the se në mbledhjen e ardhshme do të vini me informata më të detajuara do të ishte mirë për shkak se edhe ne si komunitet do të kishim mund ti identifikojmë nxënësit që tash do të regjistrohen në vitin e ardhshëm shkollorë, pra sa nxënës do ta vazhdojnë klasën e IX-të, apo sa nxënës do ta vazhdojnë shkollimin e mesëm, dhe të shohim mundësinë që përmes ndonjë organizate t'ju sigurohet ndonjë pajisje teknologjike pasi duke u bazuar në gjendjen aktuale ka mundësi që edhe në shtator mësimi do të zhvillohet në distancë, andaj të mundohemi të bëjmë diçka për fëmijët e Komuniteteve jo shumicë.

Konsideroj se kjo pikë e rendit të ditës përfundoj.

4. Identifikimi i kërkesave për projekte në infrastrukturë dhe shqyrtimi i tyre për realizimin e tyre, me rëndësi për komunitetet jo shumicë.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, theksoi, ne e kemi ftuar drejtorin z.Hamdi Jaha të jetë prezent apo ndonjë zyrtar të Drejtorisë përkatëse në këtë mbledhje por nuk e di përse nuk i është përgjigje ftesës. Jam në dijeni se para disa ditëve një grup i qytetarëve të Komitetit jo shumicë ka pasur takim me drejtorin e DPUMM z.Hamdi Jaha të cilët kanë biseduar rreth problemeve me rrjetin e kanalizimit në Lagjet “Ali Ajeti” dhe “Xhafer Meta” si dhe për disa rrugica dhe asfaltimin e tyre, andaj do të ishte mirë që ndokush nga ajo drejtori të jetë prezent në këtë mbledhje dhe të na informoj më në detaje, mirëpo si do që të jetë vazhdojmë me punë, urdhëroni nëse keni diçka për të shtuar rreth kësaj teme.

z.Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim - ZKKK, theksoi, kemi pasur takim më herët por unë edhe kam kontaktuar me drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM por edhe me drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit - DSHPMSH, dhe në bazë të bisedave dhe konstatimeve që i kemi bërë duke analizuar infrastrukturën në mënyrë gjenerale në Komunë të Podujevës dhe duke i përfshirë edhe shumë hapësira që janë punuar dhe janë duke u punuar bukur shumë. Komunitetet jo shumicë që bashkëjetojnë në Komunën e Podujevës kanë një infrastrukturë bukur shumë të shtrirë shtrirë por është normale që duhet të vazhdohet, shumë rrugë dhe rrugica janë përfunduar por që kanë mbetur edhe të tjera për tu rregulluar, tani ka kaluar faza e ndriçimit, rregullimit të parqeve dhe ambientit, dhe në bazë të diskutimeve dhe kontakteve që kemi me drejtorin e DSHPMSH dhe me drejtorin e DPUMM, por edhe me të tjerët jemi pajtuar që deri në muajin shtator të gjithë qytetarët apo përfaqësuesit e lagjeve të bëjnë kërkesa në formë të shkruar dhe t'i adresojnë problemet e tyre

për secilën lagje, atëherë zyrtarë të kësaj Drejtorie por edhe të tjerave dalin e shikojnë gjendjen faktike të asaj lagjeje, e që mendoj se janë punë që kryhen.

Pra nuk është mirë me ardh nga 20 persona për një çështje por vetëm një të cilin e delegon lagja apo lokaliteti përkatës. Unë kam qenë edhe në fshatin Orllan dhe i kam dërguar kërkesat apo si të them rekomandimet për dy lagje të cilat duhet të asfaltohen rrugicat. Këto çështje mund të ngritën edhe në Kuvendin e Komunës pasi këtu në këtë komitet kemi edhe anëtar të Kuvendit dhe të mundohen të gjejnë zgjidhje qoftë me rishikim të buxhetit aktual qoftë me miratim të buxhetit për vitet në vijim, dhe në fund ta dimë gjendjen faktike të gjithë.

Prandaj e them që është mirë që gjithmonë që përfaqësuesit e lagjeve me kërkesa dhe dokumentacion përkatës në bazë të nevojave të paraqesin tek organet e Komunës problemet, shqetësime apo çfarëdo që kanë, si për rrejt të kanalizimit, trotuar, ndriçim, asfaltim e të tjera, dhe deri në muajin shtator mund t'i paraqesin kërkesat e tyre në mënyrë që ato pastaj të shqyrtohen dhe të futen në buxhetin e Komunës për vitin 2021 apo në planifikime për dy vitet pasuese, mirëpo edhe Ju kryesuese e Komitetit për Komunitete është mirë që t'i njoftoni përfaqësuesit e Komuniteteve qoftë në lagje apo lokalitete të ndryshme në mënyrë që ata të jenë në dijeni dhe t'iu drejtohen organeve varësisht nevojave që kanë.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, theksoi, besoj që gjatë këtij viti apo edhe vitin e ardhshëm do të merren parasysh këto kërkesa dhe do të realizohen kërkesat e lagjeve dhe lokaliteteve të ndryshme ku banojnë familjet e komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, pyetje për z.Liman Zeqirin, te lagja (Cigllana) që është, kanë një problem me kanalizimin, ndoshta e dini për një projekt që është 220,000.00€, çfarë është problemi aty, ka qenë një kanalizim (Fi-300), pastaj është vendos një pjesë (Fi-150), një pjesë pastaj ka mbete zbrazëtirë edhe është mbet rruga e prerë dhe nuk janë duke vazhduar procedurat tek kanalizimi aty, a mundeni më qartë të na shpjegoni se çfarë është problemi.

z.Liman Zeqiri, shëf i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, theksoi, e kuptoj për ku e keni fjalën, tek Fabrika e tjegullave apo ish “Cigllana”, është fakt ashtu si e detajove, por për këtë çështje është projekti i detajuar dhe ideor, projekti i detajuar e përcakton a duhet me qenë gypi (Fi-300 apo Fi-150) për këtë çështje më shumë kompetent janë Drejtoria e Shërbimeve Publike mbrojtjes dhe Shpëtimit e që do të ishte mirë të ishte ndokush nga kjo Drejtori prezent këtu, pastaj edhe projektuesi i cili edhe duhet të jap sqarime përse është bërë kalimin i gypave prej Fi-250 në Fi-150 apo prej Fi-300 në Fi-200 dhe a mund ta përballoj ai kanalizim edhe faktorin demografik, mandej numri i shtëpive e të tjera sepse ata janë ekspert në lëmin e vetë dhe normal se duhet të japin sqarime dhe pastaj dihet edhe buxheti, shembull, buxheti ka qenë kaq, projekti ka qenë ky, detajet kanë qenë këto dhe arsyetimet pse është shndërruar në këtë.

Pra ju kërkoj falje sepse ndoshta nuk jam kompetent të jap këtë përgjigje por Drejtoria përkatëse është ajo që duhet shtruar këtë çështje.

z.Bashkim Sylja, theksoi, në vitin e kaluar i kemi bërë disa vizita dhe pothuajse të gjitha projektet dhe kërkesat janë bërë përmes përfaqësuesve të lagjeve të Komunitetit jo shumicë.

Edhe unë pajtohem se do të ishte mirë të ishte prezent këtu ndokush nga Drejtoria përkatëse në mënyrë që të kemi sqarime dhe informata adekuate rreth realizimit apo jo të kërkesave të Komuniteteve jo shumicë. Gjithashtu edhe unë mendoj se edhe këtë vit përmes tyre duhet të sjellën kërkesat dhe të njëjtat t'iu parashtrohen Drejtorive përkatëse.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, theksoi, sa i përket kësaj teme, gjithashtu dëshiroj ta ndaj me jo një informatë, Ministria e Financave, me buxhetin e rishikuar të Republikës së Kosovës për vitin 2020 është ndarë buxhet për ndërtimin e rrugëve të reja, rregullimin e infrastrukturës, asfaltimin e rrugicave në vendbanimet dhe fshatrat, në lagjet e komuniteteve Ashkalinj, Rom dhe

Egjiptas, për katër komuna Ferizaj, Lipjan, Gjakovë edhe Podujevë, prandaj besoj që në vitin e ardhshëm kërkesat e lagjeve të Komuniteteve jo shumicë do të hasin në mirëkuptim dhe dhe do të realizohen.

5. Të ndryshme

Nuk pati diskutime.

Kryesuesja e Komitetit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11;10

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr. 01-060/04-0035367/20
Podujevë,
10 korrik 2020**

**Kryesuese e Komitetit
Albina Avdiu**